


REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Nr. Prot. Prot. No. Data Datum Date	Z-D 01-35-2012 06-01-2012 PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.01.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-01-3029/11, për z. **Blerim KUQI** – Kryetar i Komunës së Suharekës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt të mundshëm Interesi në ushtrimin e Funksionit Publik me numër protokoli AKK-01- 3029/11, është trajtuar me të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 3).

Pas informacionit për dyshimin e ekzistimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia Kundër Korrupsionit i ka bërë shkresën e parë njoftuese Zyrtarit të Lartë, Blerim Kuqi, me datën 28.06.2011. Kësaj shkrese, zyrtari Kuqi, i është përgjegjur me datën 04.07.2011, me shkresë zyrtare, por edhe me prezencën e tij në takim me zyrtarët e Agjencisë. Gjatë prezantimit të dokumentacionit për biznesin e dyshuar me të cilin mund të kishte situatë të konfliktit të interesit të zyrtarit Blerim Kuqi, kemi konstatuar se ztr.Blerim Kuqi në biznesin privat: N.P.N. “Hidroterm” Sh.p.k. ka vetëm funksionin e pronësisë, ndërsa nuk mban asnjë nga postet menaxhuese të ndërmarrjes.

Kjo është dëshmuar nga informacionet zyrtare që kemi marr nga Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë (ARBK).

Prandaj në bazë të këtyre informacioneve, ushtrimi i funksionit të Kryetarit të Komunës dhe pronësia në biznesin privat nuk paraqesin konflikt interesi. Kjo gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Ligji Nr.04/L-051).

II. Çdo situatë tjetër e mundshme e paraqitjes “rast për rast” e konfliktit të interesit (Neni 13, i Ligjit Nr. 04/L-051) nuk e përjashton nga përgjegjësia Kryetarin e Komunës, Blerim Kuqi, dhe në të gjitha këto raste eventuale, ztr. Kuqi obligohet të bëjë deklarinimin e interesave private.

Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

